

## **PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:**

### **“PIKE SHITJE ME PAKICE TE KARBURANTEVE DHE GAZIT TE LENGSHEM GNL”**

**Vendodhja:** Elbasan, Bradashesh, Katund i Ri, Autostrada Elbasan  
– Metalurgjik, km 3, ne te djathte te autostradës, kodi postar  
3009, zona kadastrale 2124, nr pasurie 137/3

**Kërkues:** Subjekti: “Italian Petroleum Albania” sh.p.k

Janar, 2021

## TABELA PËRMBLEDHËSE

TABELA PËRMBLEDHËSE .....	2
1 TË PERGJITHSHME .....	3
2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT .....	4
2.1 Qëllimi i projektit .....	4
2.2 Të dhëna teknike të aktivitetit .....	4
2.3 Vendodhja e objektit .....	5
2.4 Lidhja e objektit me infrastrukturën Inxhinierike .....	6
2.5 Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit.....	7
2.6 Informacion për shkarkimet në mjedis .....	10
2.7 Presione kryesore të mjedisit në zonën e projektit .....	10
2.8 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis.....	10
2.9 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve.....	12
2.10 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.....	13
3 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTËSE.....	15
3.1 Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve .....	15
3.2 Masat zbutëse në fazën operacionale .....	15
3.3 Masat Parandaluese .....	20
3.4 Masat Kontrolluese .....	20
3.5 Masat Nderhyrese .....	21
3.6 Masa lehtësësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e transferimit të mbetjeve	21
4 PROGRAMI MONITORIMIT.....	23
4.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor .....	23
4.2 Objektivat e Monitorimit.....	23
4.3 Plani i monitorimit.....	23
4.4 Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	24

## 1 TË PERGJITHSHME

Subjekti juridik "Italian Petroleum Albania" Sh.p.k me administrator Z. Eduart Seital, është regjistruar në QKB me NUIS, L52912201M për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e tregëtimit me pakicë të naftës, benzines dhe nënprodukteve të tyre, gazit të lëngshëm për automjete.

**Subjekti "Italian Petroleum Albania" sh.p.k ushtron aktivitetin e tij në adresën: Elbasan, Bradashesh, Katund i Ri, Autostrada Elbasan – Metalurgjik, km 3, ne te djathte te autostradës, kodi postar 3009, zona kadastrale 2124, nr pasurie 137/3.**

Te dhenat e pronës sipas certifikates se rregjistrimit

- Pasuria nr. 137/3-ND, volumi 7, faqe 186, zona kadastrale 2124 me sipërfaqe totale 110 m<sup>2</sup>, në pronësi të zotit Bujar Gjata.

Subjekti "Italian Petroleum Albania" Sh.p.k ka lidhur kontrate me zotin Bujar Gjata për marrjen me qera të pasurisë së paluatshme të caktuar me sipërfaqe.

Shoqëria "Italian Petroleum Albania" Sh.p.k është një subjekt i cili prej vitesh zhvillonë aktivitetin e tij ekonomik të tregëtimit me pakicë të karburanteve dhe GNL në pika të ndryshme në Shqipëri në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregëtimin e karburanteve në Shqipëri.

Qëllimi i kompanisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave për kaburant me cilësi të mirë dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e aktivitetit.

Aktiviteti ka për qëllim tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe gazit GNL për automjetet me motorr me djegie të brendshme. Stacioni i kaburantit ku subjekti "Italian Petroleum Albania" Sh.p.k ushtron aktivitetin, është ekzistues. Në këtë stacion kaburanti kanë ushtruar aktivitetin e tregëtimit të lendeve djegëse për automjetet shumë subjekte të tjera.

**Subjekti "Italian Petroleum Albania" Sh.p.k për ushtrimin e këtij aktiviteti nuk disponon leje mjedisi të tipit C për këtë vendodhje të ushtrimit të aktivitetit është pajisur me leje Mjedis të tipit C me PN-7087-04-2014, Nr. 541 Prot, date 05.06.2018, me Nr. Identifikimi LMC8980EL20180605. Lejet Mjedisore të tipit C u shfuqizuan nepermjet ligjit 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR".**

Referuar shtojcës 1 të ligjit 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR" aktiviteti i tregëtimit me pakicë të karburanteve dhe GNL klasifikohet për tu pajisur me Leje Mjedis të tipit B (Shtojca 1, pika 1.7 dhe 1.10).

Për këtë arsye subjekti "Italian Petroleum Albania" Sh.p.k po ndjek procedurat për tu pajisur me leje Mjedis të tipit B për instalimet ekzistuese të tregëtimit me pakicë të karburanteve dhe gazit GNL për automjetet me motorr me djegie të brendshme .

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona

ka nje qarkullim te dendur te automjeteve. Gjithashtu pozicionimi pergjat Autostrades Elbasan – Metalurgjik si edhe krijimi I rrugeve hyrese dhe dalese per ne piken e furnizimit me karburant apo GNL krijon lehtesira per automjete qe furnizohen ne kete pike.

## **2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT**

### **2.1 Qëllimi iprojektit**

Aktiviteti ka për qëllim Tregetimin me pakice te karburanteve dhe gazit GNL per automjetet me motorr me djegie te brendeshme. Stacioni i karburantit ku subjekti “Italian Petroleum Albania” Sh.p.k ushtron aktivitetin, eshte ekzistues. Ne kete stacion karburanti kane ushtruar aktivitetin e tregetimit te lendeve djegese per automjetet shume subjekte te tjere.

**Subjekti “Italian Petroleum Albania” Sh.p.k per ushtrimin e ketij aktiviteti nuk disponon leje mjedisi te tipit C per kete vendodhje te ushtrimit te aktivitetit eshte pajisur me leje Mjedisi te tipit C me PN-7087-04-2014, Nr. 541 Prot, date 05.06.2018, me Nr. Identifikimi LMC8980EL20180605. lejet Mjedisore te tipit C u shfuqizuan nepermjet ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR”.**

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR” aktiviteti I tregetimit me pakice te karburanteve dhe GNL klasifikohet per tu pajisur me Leje Mjedisi te tipit B (Shtojca 1, pika 1.7 dhe 1.10).

Per kete arsye subjekti “Italian Petroleum Albania” Sh.p.k po ndjek procedurat per tu pajisur me leje Mjedis te tipit B per instalimet ekzistuese te tregetimit me pakice te karburanteve dhe gazit GNL per automjetet me motorr me djegie te brendeshme .

### **2.2 Të dhëna teknike të aktivitetit**

Subjekti juridik “Italian Petroleum Albania” Sh.p.k me administrator Z. Eduart Seital, është regjistruar në QKB me NUIS, L52912201M për ushtrimin e veprimtarisë në fushen e tregtetimit me pakicë te naftës, benzines dhe nënprodukteve të tyre, gazit të lëngshëm për automjete.

**Subjekti “Italian Petroleum Albania” sh.p.k ushtron aktivitetin e tij në adresën: Elbasan, Bradashesh, Katund i Ri, Autostrada Elbasan – Metalurgjik, km 3, ne te djathte te autostradës, kodi postar 3009, zona kadastrale 2124, nr pasurie 137/3.**

Te dhenat e prones sipas certifikates se rregjistrimit

- Pasuria nr. 137/3-ND, volumi 7, faqe 186, zona kadastrale 2124 me sipërfaqe totale 110 m<sup>2</sup>, ne pronesi te zotit Bujar Gjata.

Subjekti “Italian Petroleum Albania” Sh.p.k ka lidhur kontrate me zotin Bujar Gjata per marrjen me qera te pasurise se paluatshme te cituar me siper.

Shoqëria “Italian Petroleum Albania” Sh.p.k është një subjekt i cili prej vitesh zhvillonë aktivitetin e tij

ekonomik te tregëtimit me pakice te karburanteve dhe GNL në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregëtimin e karburanteve ne Shqipëri.

Ne kete shesh duke qene se kemi instalime ekzistuese te cilat jane perdorur nga shume subjektet te tjera me pare per tregëtimin e lendeve djegese per automjetet, kemi te ngritur gjithë infrastrukturen e nevojshme per mirefunksionimin e aktivitetit te tregëtimit me pakice te karburanteve dhe gazit GNL.

Produktet qe tregëtohen ne kete aktivitet jane:

- Benzine;
- Diesel;
- Gaz GNL;

Subjekti, për ushtrimin te aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij, referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR”.

### 2.3 Vendodhja e objektit

Aktiviteti “Pike shitje me pakice karburanteve dhe gazit GNL” ndodhet pergjat Autostrades Elbasan – Metalurgjik, km 3, ne te djathte te autostradës, kodi postar 3009, zona kadastrale 2124, nr pasurie 137/3, Katund i Ri, Bradashesh, Elbasan. Trualli ne te cilin ushtrohet aktiviteti ndodhet ne nje terren te rrafshet. Prona karakterizohet nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk eshte i ndjeshem. Zona ku ushtrohet aktiviteti ekzistues shtrihet ne brendesi te zonave Urbane te Bashkise Elbasan, sipas hartes se meposhteme.




Figure 1 – Harta e planifikimit urban te Bashkise Elbasan. (Burimi: ASIG Geoportal)

Aktiviteti është lehtësisht i aksesueshem pasi shtrihet përgjat Autostrades Elbasan – Metalurgjik, km 3, në të djathtë të sajë. Gjithashtu pozicionimi i aktiviteti përgjat Autostrades Elbasan – Metalurgjik krijon lehtësira në aksesimin e tij si për furnizimin e me lende të pare (karburant dhe Gaze GNL) dhe tregëtimin e tyre me pakice por edhe për automjetet e zjarrfikses në rast të aksidentëve të mundeshme si rena e zjarrit apo ambulancave në rastet e aksidentëve me pasoje në shëndetin e punonjesve.

Zona e përzgjedhur për ushtrimin e këtij aktiviteti është e përshtatshme për këtë lloj aktiviteti duke para parasysh përparesit si:

- Furnizimi me ujë;
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtësi në aksesim nga automjetet (cisternat, automjetet që furnizohen, zjarrfikset dhe ambulancat)

#### **2.4 Lidhja e objektit me infrastrukturën Inxhinierike**

Aktiviteti në vlerësim ndodhet përgjat Autostrades Elbasan – Metalurgjik, km 3, në të djathtë të autostradës, kodi postar 3009, zona kadastrale 2124, nr pasurie 137/3, Katund i Ri, Bradashesh, Elbasan. Sheshi ku hvilohet aktiviteti në fjalë ndodhet në brendësi të pronës dhe nuk cenon pronat e tjera përreth.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka një qarkullim të dendur të automjeteve. Gjithashtu pozicionimi përgjat Autostrades Elbasan – Metalurgjik si edhe krijimi i rrugëve hyrëse dhe dalje për në pikën e furnizimit me karburant apo GNL kërkojnë lehtësira për automjete që furnizohen në këtë pikë.

Infrastrukturat në zonën e ushtrimit të aktivitetit është e gatshme ku përfshihen, infrastruktura rrugore, rrjeti I furnizimit me ujë të pijshëm, rrjeti I furnizimit me energji elektrike, rrjeti I shpërndarjes së internetit si edhe të gjitha instalimet teknologjike të nevojshme për funksionimin e aktivitetit. Në këtë instalim ekzistues është aplikuar edhe sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit.

#### **2.5 Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit**

Karburanti furnizohet me mjetet e tipit cisterne nga subjekte të ndryshme të tregëtit dhe depozitimit me shumicë të lendeve djegëse për automjetet. Mbushja e depozitave bëhet pa ndërprerje të procesit të shitjes. Remontet eventuale dhe të vazhdueshme të pikës së shitjes dhe ato në raste avarish, mund të bëhen në vazhdim dhe pa ndërprerjen e tregëtit të karburantit.

Rezervuarët janë të futur në toke dhe të mbështetur në jastëke betoni, ku anash janë të mbushur me stabilizant për të krijuar siguri maksimale të tyre. Operimi në pikën e karburantit është 7 ditë në javë nga 24 orë.

## ➤ Skema Teknologjike

Skema teknologjike e furnizimit të rezervuareve me karburante dhe gaz GNL është zgjedhur e tillë që siguron furnizimin e tyre me cikël të mbyllur për të evidentuar aromën dhe avullimin e tyre në mjedis, gjithashtu edhe për të evidentuar rrezikun e zjarrit gjatë furnizimit të rezervuareve në temperatura të larta.

Për furnizimin e automjeteve me karburante dhe gaz GNL shërbejnë aparatat (distributore) elektronike që kanë një precizion kalibrimi në të njëjtat e litrit. Këta distributore furnizohen nga pompat përkatëse të vendosur në rezervuarët përkatës.

Për manovrimin e mjeteve brenda pikës së karburantit janë zbatuar kushtet teknike, ku është projektuar korsia e ngadalesimit të mjetit, furnizimi me karburant në të dy anët e distributoreve (pasi ka mjete që kanë furnizimin në karburant në anë të djathtë ose majtë), distanca minimale e zyrës nga distributori por edhe e distributoreve ndërmjet tyre është e mjaftueshme që mjetet të kenë mundësi të kalojnë lehtë. Në dalje të karburantit është edhe korsia e pershejtimit ku mjeti futet në korsinë e rrugës kryesore. Në hyrje të karburantit dhe dalje të tij janë vendosur tabelat sinjalizuese.

Depozitat janë përgatitur prej një lloji çeliku dhe janë të formuara me anë të saldimit. Forma e tyre është standarte (cilindrike). Spensori i llojit është i trashë, duke garantuar kështu një përdorim, siguri dhe jetegjatesi pa krijuar probleme teknike apo avari të ndryshme gjatë funksionimit të pikës së karburantit. Ato janë të pajisura me kapak në formë rrethore që lidhet me korpusin e rezervuarit (trupin) me bulonë. Nepermjet këtij kapaku bëhet kontrolli periodik i tyre.

Kapakët janë të siguruar me kyç (dryn) për të evidentuar vjedhjen apo ndonjë rrezik të mundshëm nga karburanti. Depozitat janë me veshje të dyfishtë të vendosura në tokë të betonuar të vendosur në një gropë të mbushur me rërë të lagur, me qëllim për të ruajtur temperaturën konstante në të gjitha stinët e vitit.

Depozitat kanë një sistem të detyrueshëm të tokësimit me qëllim që të mbrohen në rast të lidhjeve të shkurtra elektrike kur ka shkarkime atmosferike. Tubacionet janë prej materiali që nuk oksidohen nga agjentët atmosferikë dhe janë tubo material i xingat. Furnizimi i depozitave bëhet me autobote, të specializuara për këto qëllime, të cilat shkarkojnë karburantin nepermjet kapakut, me anë të një tubi fleksibel të përbërë nga sarricineska siguri dhe drejt në depozitë. Instalimi dhe funksionimi i pompave të pikës së karburantit bëhet në bazë të projektit teknik për të realizuar kushtet e punës.

Pompat së bashku me aksesoret e tjera siç janë tubat, pistoletat janë instaluar në mënyrë të tillë që nuk lejohen rrjedhjen e karburantit dhe të pajisura me valvulat e sigurisë (moskthimit), ku kjo e fundit është instaluar në thithjen e linjës së pompës. Pistoleta funksionon me valvulë të dyfishtë (me presionin e pompës dhe me darrë). Pompat janë të vendosura me karkasë metalike që e mbrojnë nga agjentët atmosferikë, siç është lagështia dhe ujrat e ndryshme gjatë proceseve të punës.

## **2.6 Informacion për shkarkimet në mjedis.**

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale. Do të jenë

kryesisht pluhurat nga lëvizja e automjetit (autobotit) dhe zhurmat teknologjike e ketij te fundit në mjediset e punës. Nga ky aktivitet nuk gjenerohen mbetje të ngurta. Mbetjet e gjeneruara janë vetëm mbetjet nga konsumi i përditshëm i puntorëve. Të gjitha mbetjet e grumbulluara do të dërgohen në subjektet e licensuara për trajtimin e tyre dhe të asgjësimit të tyre.

## 2.7 Ndikimet negative

### *Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis*

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jete i ndryshem, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjate ushtrimit te aktiviteit. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do vazhdoj të jetë i tillë dhe pas shumë kohësh. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga aktiviteti që ushtrohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për leje mjedisi tipi B. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nën-projektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

### *Impakti në mjedis nga menaxhimi i tij*

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me aktivitetin e tregëtimit me pakice te karburanteve dhe GNL, gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

## 2.8 Matrica e ndikimeve të mundshme në mjedis nga zbatimi i projektit

Në tabelat e mëposhtme janë identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis të projektit sipas fazave të zbatimit të tij.

Faza operationale			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
1	Cilësia e ajrit	Emetim gazesh nga automjetet dhe pluhuri për shkak të qarkullimit të tyre. Avullimi i karburanteve dhe Gazit GNL. Rrjedhjet aksidentale te depozitave apo linjes se furnizimit me lende te pare apo linjes se furnizimit te automjeteve te ndryshme.	Ndikim mesatar në cilësinë e ajrit. Ndikimi mund të shtrihet deri në një zonë rrethuese me rreze 200 m nga kufijtë e pronës. Rritja e moderuar e përqendrimit te gazeve ndotese ne zonen e aktiviteti. Mund të kontrollohet dhe shmangjet me masat e duhura të menaxhimit.



<b>Faza operationale</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Receptori Mjedisor</b>	<b>Operacioni dhe pasoja në mjedis</b>	<b>Ndikimi i mundshëm</b>
2	Zhurmë	Zhurmë e gjeneruar nga lëvizjet e mjeteve (makina, etj.).	Ndikimi do të jetë më i ndjeshëm në orare "pik" me më shumë lëvizje.
3	Cilësia e ujërave	Rrjedhjet aksidentale të depozitave apo linjes së furnizimit me lende të pare apo linjes së furnizimit të automjeteve të ndryshme.	Depertimi i këtyre në shtresat e tokës duke u perzier me ujrë netokësore. Nën veprimin e agjenteve atmosferike mund të orientohen drejt burimeve ujore sipërfaqësore duke përkeqësuar cilësinë e tyre. Ndikimi i ulët i cili mund të kontrollohet dhe shmanget me masat e duhura të menaxhimit.
4	Toka	Rrjedhjet aksidentale të depozitave apo linjes së furnizimit me lende të pare apo linjes së furnizimit të automjeteve të ndryshme.	Sheshet e qëndrimit të automjeteve dhe e ushtrimit të aktiviteteve në tersi janë të shtruar dhe të pajisura me sisteme drenazhimi, mundësia për depërtim në tokë pothuajse nuk ekziston.
5	Mjedisi socio - ekonomik	Mundësi të mira punësimi. Ofrimi i shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët. Gjenerim të ardhurash nga aktivitete shtesë.	Ndikimi socio – ekonomik është përgjithësisht pozitiv.
6	Mbetjet	Aktiviteti njerëzor i punonjësve	Ndikimi i ulët pasi këto mbetje grumbullohen në koshat që janë vendosur në ambientet e aktivitetit  Grumbullimi dhe menaxhimi nga subjekte të licencuara dhe kontraktuar nga pushteti vendor, Bashkia Elbasan.
7	Trafiku	Furnizimi me lende të pare apo furnizimi i automjeteve të ndryshme me karburant.	Ndikimi në rritjen e trafikut të zonës ku ushtrohet aktiviteti.

#### *Emetimet e zhurmave dhe gazeve të makinave të transportit në mjedis*

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë procesit të transportit, duhet theksuar se ky ndikim është i minimizuar.

Ndërkohë Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara", përcakton vlerat e lejuara të zhurmës si në tabelën e mëposhtme.

Nivelet kufi të zhurmës në mjedise të caktuara.

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	LAmaz Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, Qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110


### Shpjegime:


*LAeq (dBA)* = Niveli ekuivalent i matur në


shkallën A Koha bazë (orë) = Koha gjatë së

cilës bëhet matja

*LAmaz Fast (dB)* = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën Fast (e shpejtë)

 = Sa më e ulët që të jetë e mundur

 = Presioni zanor maksimal (*LAmaz, fast*) matur 100 mm larg veshit

 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur

 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë

## 2.9 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve

### Toka / Përdorimi i Tokës

Kryerja e aktivitetit brenda sipërfaqes së kërkuar për zhvillimin e aktivitetit. Respektimi i kushteve

teknike dhe standarteve.

*Cilësia e ajrit / Rritje e emetimeve ne ajer nga funksionimi i instalimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit*

Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtës. Mjete me kolaudim optimal. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës.

*Sistemi i drenazhimit*

Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut nga pastrimi përgjatë gjithë gjatësisë së sipërfaqes së aktivitetit,

*Mbetjet / Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në aktivitet.*

Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore.

*Zhurmat / Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve*

Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.

*Trafiku Rrugor / Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve*

Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

## **2.10 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.**

- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të kete ndikime në ndryshimin e habitateve;
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjesit do të grumbullohen në kazane të vecante. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e percaktuar nga Njesia Vendore për mbetjet urbane.
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjesve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.
- Mbetjet urbane të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara
- Jane marre masa për ndriçimin përreth (vendosja e impiantit të ndricimit).
- Jane marre masa në projekt për instalimin dhe respektimin e sinjalistikës së trafikut të cilat do të minimizonin impaktet për aksidente të mundshme.
- Për të minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, do të limitohen proceset e

zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20<sup>00</sup> e mbremjes deri ne 07<sup>00</sup> te mengjesit.

- Do te respektohen te gjitha kushtet dhe masat ne Lejen e Mjedisit qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithe perpaesite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

### **3 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE**

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në ruajtjen/magazininim, tregetim, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO2, NOx, SOx në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë efçente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti “Italian Petroleum Albania” Sh.p.k, do te hartojë “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme:

#### **3.1 Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve**

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve të identifikuar negative në mjedis. Këto masa duhet të synojnë:

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së punimeve;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes ku zhvillohet aktiviteti, si dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj;
- Plan - organizimi në mënyrë që të mos impaktohen sipërfaqet jashtë ndërhyrjes; Kontrolli i mbetjeve të përziera të gjeneruara gjatë gërmimeve për hapjen e themeleve të objektit;
- Hapja e kanaleve të nevojshëm perimetral për kullimin drejtimin e ujrave të shiut, me qëllim shmangien e ndotjes në ujëra;
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagies së zonës;
- Kontrolli teknik i linjes se furnizimit dhe depozitave për të parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe çlirimet tej normave të gazeve.
- Kontrolli teknik i automjeteve për të parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe çlirimet tej normave të gazeve.

### **3.2 Masat zbutëse në fazën operacionale**

#### **1. Per evidentimin e ndotjes nga karburantet qe mund te rrjedhin gjate furnizimit te depozitave me autobot ose gjate furnizimit te automjeteve ne distributor.**

- Kanali i grumbullimit te ujrave dhe karburanteve qe eventualisht mund te rrjedhin gjate manipulimit te tyre, do te perfundojne ne seperatorin e ndarjes se hidrokarbureve nga uji;
- Rezervuaret (kapcitetet depozituese) jane me spensor mbi 4 mm, ne forme cilindrike horizontale, te lyer me boje anti-korrozive. Linjat e furnizimit te dyfishte si dhe tubat e ajrimit jane te montuar ne rezervuare konform kerkesave tekniko-teknologjike te eneve nen presion. Ato jane te vendosura ne gropa vaska betoni te hidroizoluara dhe me material termoizolues dhe stabilizant. Mbas montimit te tyre dhe lidhjes se linjave te furnizimit me distributoret, ato jane provuar per ndonje carje te mundshme me zbatimin e nje presioni hidraulik prej minimumi 0.75 kg/cm<sup>2</sup>.
- Furnizimi i rezervuareve do te behet me autobote, parametrat teknike dhe teknologjike do te jene ne perputhje me kerkesat e eneve nen presion. Shkarkimi i karburantit prej tyre do te behet nepermjet tubave te gomuar qe sigurojne nje rrjedhje ne presion konstant ne pusetat perkatese mbi bokarpot e rezervuareve. Muftat bashkuese ne te dy ekstremet e tubit te gomuar do te jene objekt i rendesishem kontrolli per riparim apo zevendesim te mundshem ne rast demtimi.
- Furnizimi me karburante do te behet me distributor universal nepermjet pistoletave.
- Dsitributoret do te jene venditur ne bazament beton duke respektuar rigorozisht balancimin, distancat e lirshmerive ne manovrimet e tyre ne pozicione te ndryshme. Gjate sherbimit, kolaudimit apo ndonje riparimi te mundshem te paisjeve te distributoreve (pompa, tuba fleksibel, pistolete, etj), jane marre masa qe karburantet te derdhen ne ene te posacme apo kanale lengmbledhese qe jane ndertuar prane distributoreve dhe qe vazhdojne per ti rikthyer ne depozite, pa lejuar rrjedhjen ne mjedis.

#### **2. Menaxhimi i ujrave te ndotura me mbetje**

- Ujrat e godinave apo zyrave qe mund te precipitojne nga reshjet apo larjet ne sheshin para tyre, do te kullojne ne kanalet anesore nga ku te grumbulluara, do te vazhdojne te shkarkohen ne pusetat anesore te stacionit.
- Ujrat e ndotura urbane (ujrat e zeza) qe do te shkarkohen nga tualeti (WC) do te shkarkohen direkt ne rrjetin e kanalizimeve ne kolektorin kryesor te ujrave te zeza.

#### **3. Mbrojtja e ujrave nentokesore**

- Rezervuaret jane cilesisht te garantuara si dhe te provuar parapraktikisht nen presion mbi provat e lejuara. Po keshtu edhe sistemi i tubacioneve furnizues te pompave te distributoreve dhe tubat e ajrimit. Siperfaqet e tyre ne kontakt me token jane te lyer me boje e lende hidroizoluese. Rezervuaret mbeshteten ne grope me jastek betoni dhe material inerte (rere+stabilizant) duke siguruar hermetizim te plote nga bazamenti dhe paretet anesore argjilore dhe subargjile te gropes. Gropa e rezervuare duke qene e betonuar, ku ne ndonje rast te mundshem te carjeve aksidentale e rrjedhje te karburantit nuk do te lejoje qe te infiltroje menjehere karurantet ne ujrat nentokesore. Ne ndihme te zbulimit te shpejte te rasteve aksidentale te tille, do te sherbeje vendosja ne grope e nje sinjaizuesi automatik. Po keshtu edhe linjat teknologjike do te jene te pajisura me aparatura paralajmeruese ne raste kontaminimi te mjedisit nentokesor.
- Distributoret jane bashkekohor dhe cilesisht te garantuar. Pjeset e tyre do tju nenshtrohen periodikisht kontrollit vizual e teknik, kryesisht per ndonje carje te mundshme, per te cilat do te kete sinnjalizues automatik. Lidhjet teknologjike me rezervuaret do te garantohen nga sisteme tubash fleksibel te cilesise se larte. Teresia e bazamentit te betonit dhe vendosjes se distributoreve eshte conform parametrave rigorozisht te percaktuar. Paralelisht me distributoret eshte ndertuar nje kanal I vogel per te garantuar grumbullimin e rrejdhjeve ne ndonje rast te mundshem, e qe me tej do ti drejtoje ato ne nje minidepozite te posacme per te tilla raste.

#### **4. Menxhimi i mbetje**

- Mbetjet jo te rrezikeshme do te vecohen nga komponentet e pastera dhe do te grumbullohen per nje depozitim dhe riciklim te mundshem.
- Mbetjet e rrezikeshme ne te cilat do te bejne pjese ato vajore, Vajra rrjedhese, detergjente etj, do te depozitohen ne nje kontenier te caktuar per grumbullimin e ketyre mbetjeve.
- Minimizimi dhe evidentimi i zhurmave te mundshme
- Vendodhja e stacionit te karburantit eshte ne ane te rruges dhe Jo prane ndonje qendre. Gjenerimi I zhurmave eshte brenda normave te lejuara dhe nuk do te kete shqetesim per banoret perreth. Eshte parashikuar edhe zona e ngadalesimit te mjetit perpara se mjetet te hyjne ne karburant cka minimizon edhe nivelin e zhurmave.

#### **5. Minimizimi i ndotjes se ajrit**

- Per ruajtjen e nje temperature konstante sidomos gjate stines se veres, si kusht I domosdoshem paraprak per minimizimin deri ne eliminim te avujve nga aerosoleve te karburantit gjate furnizimit ritmik te automjeteve ne distributor edhe te furnizimit te rezervuareve, pjesa e siperme e depozites nentokesore deri ne bokaportin e furnizimit, do te fete me nje shtrese rere per termoizolim. Gjithstu pistoletat Jane te kalibrura dhe mbyllje

automatike te cilat nuk lejojne rrjedhje te karburantit, cka do te krijonte aroma te pakendeshme ne mjedis.

## **6. Menjanimi i korrozionit dhe carjes se depozitave**

- Per menjanimin e gerryerjeve dhe carjeve nga korrodimi te depozitave, do te merren te gjitha masat paraprake dhe ato kontrolluese gjate funksionimit qe kemi permendur me siper.

## **7. Zgjidhja e problemit te zjarrit nga shkarkesat elektrike**

- Te gjitha paisjet e mjetet si rezervuari, linja teknologjike, pompat etj, ku ruhet e qarkullon karburanti, per te eliminuar rreziquet e krijimit ne to te ngarkesave elektrostатike jane te tokezuara.
- Per te gjithe sistemin e linjave qarkulluese nuk do te kete saricinecka nderprerese por bashkim me fllanxha, qe te jete eliminuar lidhja elektrike e vazhdueshme me ane te urave.

### **Mbrojtja nga Zjarri**

Subjekti "Italian Petroleum Albania" sh.p.k per ushtrimin e ketij aktivitet ka marre te gjitha masat e duhura ne baze te kushteve te parandalimit dhe mbrojtjes kundra zjarrit (PMKZ) per nje funksionim normal dhe pa avari te paisjeve te ndryshme dhe te pikes se karburantit ne teresi.

Paisjet e mbrojtjes kundra zjarrit per kete objekt jane te nje rendesie te vecante, dhe jane te domosdoshme si nje pike themelore e funksionimit te tij. Instalimi ekzistues eshte i pajisur me nprojektin e mbrojtjes nga zjarri ku jane parashikuar te gjitha masat qe duhen te ndermerren ne raste te jashtezakonshme, te parandalimit te zjarrit dhe menaxhimit te situates se rrezikut te zjarrit ne raste te vecanta.

## **8. Masat per mbrojtjen e mjedisit**

Masat per mbrojtjen e mjedisit qe jane marre nga ana e subjektit Jane:

- Rregullimi, sistemimi dhe rrethimi i territorit
- Instalimi i sistemit te ndarjes se ujrave te kanaleve te grumbulluara nga kanalet siperfaqesore te objektit
- Jane bere kanalizimet e brendeshme te objektit te lidhura me tubacionin kryesor qe shkarkohet ne kanalin prane objektit
- Mbetjet e ngurta jo te rrezikeshme qe do te krijohen do te grumbullohen ne stacionin e karburantit dhe periodikisht nga stafi i punes do te perfundojne ne konteneret e zones e me pas me ane te sherbimit te transportit te mbetjeve nga Bashkia do te shkojne ne landfillin e Sharres.



- Projekti perputhet me Planin e Pergjithshem Vendor te Bashkise Elbasan miratuar nga KKT, ku ky objekt eshte i ndertuar tashme dhe me leje ndertimi te miratuar. Kjo siperfaqe i perket njesise strukture TH-UB-090.

### **3.3 Masat Parandaluese**

- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë proceseve të ndryshme në aktivitet.
- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.
- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.
- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Mbajtja gjithmone fikur e automjeteve kur nuk eshte e nevojshme perdorimi I tyre dhe ruajtja e distances së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit;
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës,
- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundra ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike te larjes dhe të shiut, si dhe mirëmbatja e pemëve.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.

### **3.4 Masat Kontrolluese**

- Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike
- Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.
- Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.
- Vëzhgimi dhe kolaudimi i vazhdueshëm i të gjithë makinerive te transportit.
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
- Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

### **3.5 Masat Nderhyrese**

- Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/makinerive nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.
- Kapja, asgjësimi i menjehershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjehershëm i ambientit të punës me detërgjentë të posaçëm, që mund të gjenerohen nga veprimtaria dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.
- Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/ makinerive dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.
- Riparimi i menjehershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.
- Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.
- Njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme.
- Pajisja e zones së aktivitetit me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.
- Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).
- Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim.

### **3.6 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e transferimit të mbetjeve:**

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Është detyrë e zhvilluesve të aktivitetit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.

- Është detyre e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të transferimit të mbetjeve
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të ambalazheve, letra- kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjediseve të gjetëruara. Mjedis i gjëlburuar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedimore të nevojshme.
- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave, etj.
- Eshtë ndertuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në instalimin për ruajtjen/magazinin transferimin e mbetjeve.

## **4 PROGRAMI MONITORIMIT**

### **4.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor**

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

### **4.2 Objektivat e Monitorimit:**

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të tij.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e funksionimit të aktivitetit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktivitetit që kryhen në rajonin ku zhvillohet aktiviteti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

### **4.3 Plani i monitorimit**

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime për trejetimin me pakice të karburanteve dhe GNL, i pozicionuar në Zona Uranë, Elbasan, nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në sheshin e transferimit por dhe në një zonë mbi 50 m për rreth sheshit ku do të zhvillohet aktiviteti.

Plani i monitorimit do të konsistojë në:

- Monitorimi i parametrave tekstin të instalimit.
- Monitorimi i zonës së mundshme të gjenerimit të aromave gjatë zhvillimit të veprimtarisë
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura në sipërfaqen e aktivitetit

#### **4.4 Plani i monitorimit te ndikimit ne mjedis.**

Do te kryhet monitorimi I pluhurave, i zhurmës cilesise se ujrave megjithëse ne kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

<b>Nr</b>	<b>Elementii Monitorimit</b>	<b>Frekuenca</b>	<b>Analiza</b>	<b>Përgjegjësi</b>
1	Monitorim i gjithë shkarkimeve të ujrave që shkarkohen nga instalimi	Periodike Parametrat	Analize e plote.  kimike: nitrate, nitrite, BOD, COD, metale, hidrokarbure. Aromat, temperature, pluhurat,	Firma  Firma
2	Monitorim i shkarkimit të grimcave të pluhurit, gazrave gjatë magazinimit/ruajtjes, transferimit te mbetjeve.	Vazhdueshëm	Ne pika te ndryshme te stacionit te transferimit dhe rikuperimit SOx, CO, CO2	
3	Monitorim i gazeve nga mjetet e transportit	Vazhdueshem	NOx, SOx, CO, CO2, O etj Firma Vazhdueshëm	
4	Monitorim i gjendjes së mekanikës dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë.		Zhurmat dB(A) Firma	
5	monitorimin e mbjelljes së kurorës së pemëve	Periodike	sasiore	Firma
6	Sasia e mbetjeve te transferuara	Vazhdueshem	Sasiore	Firma

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron funksionimi I ketij aktiviteti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të instalimit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.

Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderushëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.